



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA DOGANËS Durrës

Nr. 4025 Prot.

Durrës, më 12/03/2025

Lënda: Kërkesë për Shpallje Publike Publike

Drejtuar: DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE
DREJTORISË SË BURIMEVE MBËSHTETËSE

Në vijim të marrjes së masave për Rikuperimin me Forcë të Borxhit Doganor, mbështetur në Ligjin "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 të D.P.D-së "Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës", Kreu VI "Njoftimi i Vendimit", pika 3, b) "Rastei e mos marrjes së konfirmimit të njoftimit", si dhe në zbatim të nenit 130-141/a të Kodit të Procedurës Civile, Ju drejtohem për të mundësuar njoftimin online/në faqen zyrtare të DPD-së, të subjektit/shtetasit debitor të poshtëshënuar pasi nga ana jonë nuk është mundësuar Njoftimi i Vendimit Administrativ; VRFB-së; Urdhërit të Ekzekutimit; sipas rastit përkatës në tabelë.

Nr	Subjekti Debitor		Shuma e Borxhit	Nr, Date Vendimi		Titullit Ekzekutiv		Urdheri i Ekzekutimit	
1	AUGUSTO GUZA	K52218504Q	347,484	139	24.02.2025				
2	MANUFACTURE SHOES	M22413003E	188,952	138	24.02.2025				
3	GEREM KONFEKSIONE	M22119508D	200,000	1051	16.12.2024	21	25.02.2025		
4	GEREM KONFEKSIONE	M22119508D	1,046,484	1052	16.12.2024	22	25.02.2025		
5	GEREM KONFEKSIONE	M22119508D	50,000	1053	16.12.2024	23	25.02.2025		
6	GEREM KONFEKSIONE	M22119508D	50,000	1054	16.12.2024	24	25.02.2025		
7	GEREM KONFEKSIONE	M22119508D	353,556	1055	16.12.2024	25	25.02.2025		

Ju falenderojmë për bashkëpunimin!

KRYETARI
DENIS SHABANI



MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS DURRËS

Nr. 2370 / 3 prot.

Durrës, më 12.03.2025

Lënda: Dërgim Informacioni për statusin e eksportuesit të miratuar

Drejtuar: DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANVE
DEPARTAMENTI TEKNIK I AKCIZËS DHE PROCEDURAVE DOGANORE
DREJTORIA E TARIFËS DHE ORIGINJËS

Në vijim të shqyrtimit të aplikimit, protokolluar me tonën Nr.2370prot, datë 11.02.2025, për paisjen me Statusin e Eksportuesit të Miratuar, nga kompania "ALBANIA REFINERY&JEWELLERY PRODUCTION" shpk, me NIPT M41324504C, adresë: Katund i Ri , Bisht Kamëz, Durrës, e cila operon nën Regjimin e Përpunimit Aktiv me Autorizimin AL 38834/1, datë 19.02.2025 dhe AL 29333/1 datë 21.02.2024, në zbatim të Urdhërit Nr. 09 datë 24.01.2018 "Për Miratimin e Rregullores mbi Eksportuesit e Miratuar", nga verifikimet e kryera lidhur me aktivitetin eksportues të kësaj kompanie për mallrat me origjinë preferenciale, ju informojmë sa më poshtë:

Dega Doganore Durrës, si Zyrë Doganore mbikqyrëse, me shkresën Nr.2370/1prot, date 17.02.2025, kërkoi informacion nga Dega Doganore Rinas, si Zyrë e autorizuar hyrje dhe dalje e mallrave në Autorizimin e RPA.

Produktet e përpunuara nën regjimin e përpunimit aktiv që rieksporthen me procedurën 3151: me origjinë preferenciale, në kodin 4 shifror të NK: **7113** (*Varëse floriri,*), pa origjinë preferenciale, në kodin 4 shifror të NK: 7106 dhe 7108.

Mallrat që vendosen nën regjimin doganor (RPA) me procedurën 5100 janë në kodin e NK: **7106** (*Argjend i papërpunuar*) ; **7108** (*Fleta dhe pllaka ari*).

Operacionet e përpunimit janë: Përpunimi termik i metaleve të cmuar me anë të furrave me induksion dhe paisjeve të tjera, shkrirje, petëzim, fijëzim, ndricim, prodhim i bizhuterive.

Për periudhën kohore, 21 shkurt 2024, deri 17 shkurt 2025, nga shoqëria “ALBANIA REFINERY&JEWELLERY PRODUCTION” shpk, janë deklaruar në Degën Doganore Rinas, 6 copë deklarata doganore Exp.3 (kodi i procedures 3151), nga të cilat në 3 raste nga Dega Doganore Rinas është lëshuar Çertifikata e Origjinës preferenciale EUR 1, për mallrat e rieksporuara të klasifikuara në Kodin e NKM 7113 (*Varëse floriri*), sipas kërkesave të Listës së Aneksit 2 të MSABE.

Në të gjithë aktivitetin e saj, kjo kompani ka respektuar kërkesat dhe detyrimet ligjore të përcaktuara në legjistacionin doganor, në lidhje me dhënien e origjinës preferenciale, duke plotësuar kërkesat e Nenit 6, të Titullit 2 të MSABE dhe kushtet e listes së Aneksit 2 të kësaj marrëveshje.

Gjithashtu ka plotësuar kërkesat e Kodit Doganor dhe Udhezimit Nr.4, datë 28.03.2019 “Mbi funksionimin e regjimit të përpunimit aktiv”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

KRYETAR

Denis SHABANI

